



THIRRJE PËR PJESËMARRJE

në

**KONFERENCËN E PARË KOMBËTARE TË STUDENTËVE TË FAKULTETIT
TË SHKENCAVE TË EDUKIMIT,**

me temë:

**“SFIDAT AKTUALE TË STUDENTËVE LIDHUR ME PRAKTIKËN
PROFESIONALE NË KONTEKSTIN E KOPSHTIT GJITHËPËRFSHIRËS, ME
FOKUS EDUKIMIN E FËMIJËVE NGA PAKICAT ETNIKE”**

që zhvillohet, më 14 qershor 2019, Elbasan

Kjo ngjarje mbështetet nga Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Universiteti i Elbasanit “A. Xhuvani”, në bashkëpunim të ngushtë me Organizatën “*Save the Children*”, dhe vjen në kuadër të zbatimit të projektit “*Kujdes dhe zhvillim në fëmijërinë e hershme për fëmijët romë në Shqipëri*” që financohet nga REF dhe MEDIKOR dhe zbatohet nga Save the Children, në partneritet me organizata të tjera lokale, si: Romano Sezi dhe Voice of Roma.

Konferenca ofron mundësi për studentët të cilët ndjekin programet e studimit në fushën e mësuesisë dhe aktorët e tjerë që përkrahin rrugëtimin e tyre drejt formimit profesional, që të mblidhen së bashku dhe të ndajnë me njëri tjetrin dijen dhe përvojën e fituar në kuadër të realizimit të praktikës profesionale, me fokus zbatimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe garantimin e cilësisë në edukimin për fëmijët nga pakicat etnike.

Konferenca promovon një vizion të ri të implementimit praktik të përfshirjes aktive të studentëve në procesin e prezantimit të punimeve studimore në grup, të diskutimit konstruktiv, të reflektimit mbi problemet dhe sfidat konkrete që ata ndeshin si praktikantë, si dhe të zhvillimit të ideve për të ndryshuar realitetin dhe për të sjellë kontribute të rëndësishme në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të ofruara në institucionet e arsimit të lartë.

Ky forum paraqet jo vetëm një përvojë stimuluese dhe inspiruese në karrierën profesionale të gjeneratës së re të studentëve -mësues, por u jep atyre edhe një hapësirë të shkëlqyer për të themeluar një rrjetë të përbashkët ndërveprimi dhe partneriteti për të ardhmen.

Konferenca mirëpret pjesëmarrjen e studentëve të ciklit të parë dhe të dytë të programeve të studimit në fushën e mësuesisë, studentë të degëve të tjera të interesuar për tematikën e konferencës, si dhe mësues mentorë të kopshteve dhe shkollave ku zhvillohen praktikat profesionale.

Për më tepër informacion luteni të shkruani në adresën:

konferencafshe2019@uniel.edu.al

BORDI ORGANIZATOR I KONFERENCES SË STUDENTËVE